



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2140/6 prot.

Tiranë, më 17.12.2024

VENDIM

Nr. 41, datë 17.12.2024

PËR KONTROLLUESIN “MIA FINANCË” SH.A

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Mia Financë” sh.a (në vijim “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 164, datë 01.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikim i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit Nr. 02, datë 17.01.2023 (në vijim “Rekomandimi”) të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Kontrolluesin “Mia Financë” sh.a .

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë në fushën e shërbimeve financiare, si institucion financiar i mikrokredisë dhe ofron shërbime këshilluese për kredithënien, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për veprimtarinë e institucioneve jobankare.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave personale “klientët”, “punonjës”, “aksionerë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 3 të dispozitivit Rekomandimit për zbatimin e detyrimeve në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave.

Konstatohet se, në ambientet e brendshme të kontrolluesit nuk janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-survejitimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe”, “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

3. Lidhur me përmbushjen e pikës 6 të dispozitivit të Rekomandimit, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion “*Rregulloren e rishikuar për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Mia Financë*” të miratuar më 31 janar 2023.

Konstatohet se, dispozitat e cituara në “*Rregulloren e rishikuar për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Mia Financë*” janë të përgjithshme dhe parimore por nuk ofron asnjë rregullim konkret të proceseve përpunuese të Kontrolluesit lidhur me detyrimet e Ligjit.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Rregullores konstatohet se, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit për secilën kategori të të dhënave personale, konfidencialitetin, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit për secilën prej kategorive të të dhënave dhënave personale që Kontrolluesi përpunon etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim “*Udhëzimi nr. 47*”).

duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

4. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 7 të dispozitivit të Rekomandimit lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.

Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, marrja e masave për zhvillimin dhe dokumentimin e trajnimeve të përshtatura për punonjësit, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, është një nga masat e sigurisë së të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 21.11.2024, paraqiti pretendimet mbi konstatimet e procesverbalit duke bashkëlidhur dhe provat si:

- Foto të tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, sipas formatit standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Lidhur me konstatimin e pikës 2, Kontrolluesi argumenton se: *“Mia Finance sh.a ka marrë masa për të vendosur tabelat informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, sipas formatit standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, që pas Rekomandimit nr. 02, datë 17.01.2023, por për shak të ndërrimit të ambienteve ku ushtron aktivitetin Kontrolluesi dhe zhvendosjes në ambientet e reja, në momentin e paraqitjes së inspektorëve, tabelat informuese, mund të mos kenë qënë vendosur ende ose nuk kanë qënë vendosur sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit. Megjithatë pas fillimit të hetimit janë marrë masat për të vendosur tabelën informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i mësipërm nuk qëndron, Kontrolluesi që në momentin e instalimit të sistemit të video-survejitimit në ambientet ku ushtron aktivitetin duhet të informojë subjektet e të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të videosurvejitimit (CCTV) pasi ky është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejitimi është funksional dhe në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejitimit të miratuar nga Komisioneri, për më tepër që konstatimi mbi tabelat informuese është një detyrë që Zyra e Komisionerit ka lënë për t'u zbatuar që me Rekomandimin Nr. 02, datë 17.01.2023.

Lidhur me konstatimin e pikës 3, Kontrolluesi argumenton se: *“Mia Financë sh.a nga hera e fundit e kontrollit të ushtruar nga Zyra e Komisionerit, ka rishikuar “Rregulloren për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale” dhe ka marrë masa konkrete teknike, si për back up-e të cilat më parë nuk ishin tani janë vendosur, janë blerë dy servera, si dhe është investuar për të blerë një sistem të ri”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje nuk është i mjaftueshëm në rast se ajo nuk parashikon masa konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit për secilën kategori të të dhënave personale, për të gjitha proceset gjatë ushtrimit të aktivitetit duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënave personale në mënyrë manuale dhe jo vetëm elektronike, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “b” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mospërmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18 , 27, 39 pika 1, germat “b” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

VENDOSA:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në “*Rregulloren specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, konfidencialitetin etj;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të ketë në vëmendje detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, lidhur me trajnimin e vazhdueshëm të stafit të tij;
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
 - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 4 më sipër;
 - iii. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
8. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 17.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi